

UDHËZIM
Nr. 18, datë 1.8.2024

**PËR DISA NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 30, DATË 4.11.2022, “PËR
PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE DHE AFATEVE TË APLIKIMIT, SI DHE TË
PROCEDURAVE TË PËRCAKTIMIT TË MASËS DHE MËNYRËS SË
FINANCIMIT TË STUDENTËVE TË SHKËLQYER DHE ATYRE QË NDJEKIN
PROGRAME STUDIMI QË PËRBËJNË PRIORITET KOMBËTAR”, I NDRYSHUAR**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës; të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, dhe të pikës 6, të vendimit nr. 386, datë 1.6.2022, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e fushave dhe të programeve të studimit, që përbëjnë prioritet kombëtar dhe mbështetjen financiare të studentëve të shkëlqyer e studentëve, që ndjekin këto programe në institucionet publike të arsimit të lartë”, të ndryshuar, dhe të urdhrit nr. 113, datë 26.3.2024, “Për delegimin e kompetencave dhe caktimin e detyrave të zëvendësministrit të Arsimit dhe Sportit, znj. Ana Kapaj”, i ndryshuar,

UDHËZOJ:

I. Në udhëzimin nr. 30, datë 4.11.2022, të ndryshuar, të bëhen ndryshimet si më poshtë:

a) Pika 2/1 ndryshohet, si më poshtë:

“2/1. Përcaktimi i programeve prioritare të studimit dhe kuotat e financimit për këto programe në institucionet publike të arsimit të lartë bëhet nga komisioni *ad-hoc* i ngritur pranë Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, sipas përcaktimeve të pikës 6.1, të vendimit nr. 386, datë 1.6.2022, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, dhe i dërgohen AKFAL-it. AKFAL-i njofton kuotat për IAL-të publike dhe shpërndan fondin e transferuar për këtë qëllim secilit prej tyre.”;

b) Pika 5 ndryshohet, si më poshtë:

“5. Përzgjedhja e studentëve përfitues sipas shkronjave “a”, “b” dhe “c”, të pikës 2, të këtij udhëzimi, bëhet sipas përcaktimeve në vendimin nr. 386, datë 1.6.2022, Këshillit të Ministrave, të ndryshuar. Vendimi i institucioneve publike të arsimit të lartë për përzgjedhjen e studentëve përfitues, në programet prioritare të studimit, i njoftohet Agjencisë Kombëtare të Financimit të Arsimit të Lartë. Pas marrjes së vendeve të IALve publike, AKFAL-i harton listën përfundimtare dhe ia përcjell ministrisë përgjegjëse për arsimin. Bazuar në këtë listë, ministria përgjegjëse për arsimin akordon fondin për çdo institucion publik të arsimit të lartë.”;

c) Pika 10 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“10. Për studentët përfitues. AKFAL-i do të bëjë verifikimin e plotësimit të kërkesave të pikës 4, të vendimit nr. 386, datë 1.6.2022, të Këshillit Ministrave, të ndryshuar. Për këtë qëllim, IAL-të duhet të depozitojnë, brenda muajit tetor, vërtetimin për shlyerjen e të gjithë detyrimeve të vitit paraardhës dhe/ose listën e notave sipas përcaktimeve të pikës 4, të vendimit nr. 386, datë 1.6.2022, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar. Në rast të mosplotësimit të kërkesave të pikës 4, të vendimit nr. 386, datë 1.6.2022, të ndryshuar, studenti humb të drejtën e përfitimit të mbështetjes financiare për vitin akademik pasardhës. Në këtë rast, AKFAL-i njofton studentin, institucionin publik të arsimit të lartë dhe ministrinë përgjegjëse për arsimin.”.

2. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar, Drejtoria e Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, Agjencia Kombëtare e Financimit të Arsimit të Lartë, Qendra e Shërbimeve Arsimore dhe institucionet publike të arsimit të lartë.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSMINISTËR I ARSIMIT DHE SPORTIT

Ana Kapaj